



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 272, datë 01.07.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARIT
{...}
VITI 2019

POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

TË DHËNAT E GJYQTARIT

Emri: Gentian

Mbiemri: {...}

Datëlindja: 28.05.1979

Vendbanimi: Tiranë

Adresa e e-mailit zyrtar: gentian.{...}@gjkata.gov.al

Adresa e e-mailit privat: {...}2003@yahoo.com

Numër telefoni: 0692416176

Gjykata: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Funksioni: Gjyqtar

Seksioni: Nuk ka

Vlerësimi i mëparshëm: Periudha e vlerësimit 2007-2009 / “ Shumë mirë”

Masa disiplinore: Nuk ka

Periudha e vlerësimit : 01 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2019

VLERËSUES

Relator : **Brikena Ukperaj (Lubonja)**

Nëpunës përgjegjës për vlerësimin : **Gilda Hoxha**

QËLLIMI

Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të tij për periudhën e vlerësimit 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe ai i përgjithshëm, të cilët i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare.

Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit hartohet bazuar në parashikimet e neneve 68, 89 e vijues dhe 93 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” dhe vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”.

Me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit për çdo tregues, aspekt dhe kriter vlerësimi, vlerësuesi bën analizë të integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit, ashtu sikundër ato përshkruhen dhe detajohen në raportin analitik të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

PROCEDURA

Procedura e vlerësimit të gjyqtarit {...} ka filluar me vendimin nr. 247, datë 9.7.2020, “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: Relator znj. Brikena Ukperaj (Lubonja); Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Në datën 13.7.2020, në bazë të neneve 85 pika 2 dhe 89 pika 3 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të Vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, gjyqtari është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit Janar – Dhjetor 2019 (vlerësimi i përshpejtuar i detyruar), për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të çdo anëtari të Këshillit. Brenda afatit 3 ditor, më datë 15.7.2020, gjyqtari {...}, nëpërmjet postës elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit, si dhe nuk ka kërkesë për përjashtimin e tyre ose të çdo anëtari të Këshillit.

Më datë 23.7.2020, nëpërmjet shkresës nr. 3518 prot, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kërkuar informacion, lidhur me të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së vlerësimit, viti kalendarik 2019 (1.1.2019-31.12.2019). Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kthyer përgjigje, lidhur me informacionin e kërkuar, me

shkresën nr. 1794/1 prot, datë 17.8.2020, protokolluar pranë KLGJ me nr.3576/2, datë 19.8.2020 duke dërguar informacion lidhur me ankesat si dhe kopje të tyre.

Me shkresën nr. 5351 prot, datë 21.10.2020 ILD-së i është kërkuar verifikimi i ankesave për gjyqtarët të cilët janë në proces vlerësimi etik dhe profesional, së bashku me listën emërore të ture, ndër të cilët edhe gjyqtari {...}. Në përgjigje të kësaj kërkesë, ILD me shkresën nr. 2437/4 prot, datë 9.11.2020, protokolluar në KLGJ me nr. 5351/1 prot, datë 10.11.2020, ka dërguar vendimin me nr. 895/3 prot, datë 6.11.2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shoqëria “Friends” sh.p.k”. Gjithashtu, me shkresën nr.2497/1 prot, datë 24.11.2020, protokolluar në KLGJ me nr. 5351/11 prot, datë 24.11.2020, ILD ka dërguar vendimin me nr. 1527/3 prot, datë 29.9.2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga Kudret Hankollari”, për shkak të qënies kërkesë e përsëritur. Ndërkohë me shkresën nr. 537/1 prot, datë 3.2.2021, ILD ka përcjellë vendimin nr. 1203/3 prot, datë 18.9.2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi Kudret Hasankolli”.

Më datë 24.7.2020, nëpërmjet shkresës nr. 3576 prot., Shkollës së Magjistraturës i është kërkuar informacion lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit {...} në veprimtaritë trajnuese gjatë periudhës së vlerësimit, viti kalendarik 2019 (1.1.2019-31.12.2019). Shkolla e Magjistraturës ka kthyer përgjigje lidhur me informacionin e kërkuar me shkresën nr. 536/1 prot., datë 5.8.2020, protokolluar pranë K.L.GJ me nr. 3576/1, datë 6.8.2020.

Në datën 23.7.2020, gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës, i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”. Me shkresën nr. 7262prot., datë 6.2.2020, protokolluar pranë K.L.GJ-së me nr. 3835prot., datë 6.8.2020, është dërguar “Formular i integruar i vlerësimit të gjyqtarit”. Me shkresën nr. 9428 prot, datë 9.10.2020 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë janë dërguar dy vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari të cilat nuk ishin dërguar bashkëlidhur Formularit të Integruar të Vlerësimit.

Pjesë e dosjes së vlerësimit, është bërë edhe kopja e aktit përfundimtar të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, të dërguar nga I.L.D.K.P.K.I me nr. 195/24 prot, datë 25.6.2020, protokolluar në K.L.GJ me nr. 2341/3, datë 25.6.2020.

Me procesverbalin e datës 22.7.2020 nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, bazuar në pikën 10 shkronja “b” të vendimit nr. 197, datë 11.6.2020 “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, ka evidentuar çështjet me palë kundërshtarë të përfunduara nga gjyqtari përtej afateve standarde (afat ligjor ose standard minimal kohor).

Me urdhrin me datë 24.7.2020, relatori ka disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit për periudhën e vlerësimit Janar – Dhjetor 2019, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të shortit. Urdhri i është njoftuar gjyqtarit, kryetarit të gjykatës, si dhe kancelarit të gjykatës më datë 24.7.2020, nëpërmjet postës elektronike.

Bazuar në urdhrin e relatorit, më datë 27.7.2020, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim, dokumentuar në procesverbalin përkatës. Gjyqtari nuk ka shfaqur pretendime në lidhje me procedurën e shortit.

Pas zhvillimit të shortit, me shkresën nr. 246 prot, datë 30.7.2020, protokolluar në KLGJ me nr. 3773 prot, datë 30.7.2020, janë dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit 3 (tre) dosjet e çështjeve të përzgjedhura me short. Dy dosje të përzgjedhura me short janë dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me shkresën nr. 6905/1, datë 4.8.2020, protokolluar në KLGJ me nr. 3773/2 prot, datë 4.8.2020 dhe 1 (një) dosje është dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. 1947 prot, datë 15.9.2020, protokolluar në KLGJ me nr. 3712/2 prot, datë 21.9.2020. Me shkresën nr. 11/73 prot, datë 20.11.2020, protokolluar në KLGJ me nr. 3713/3 prot, datë 20.11.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka dërguar kopje të CD-ve që përmbajnë procesverbalet e regjistrimit audio të seancave për çështjet e përzgjedhura me short.

Pas administrimit të 6 (gjashtë) dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, ka filluar nga nëpunësi përgjegjës për vlerësim, hartimi i raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}.

Më datën 7.12.2020, nga ana e nëpunësit përgjegjës për vlerësimi znj. Gilda Hoxha, është dorëzuar i përfunduar “Raporti analitik për vlerësimin etik dhe profesional”.

Me vendimin “Për plotësinë e procedurës dhe dokumentacionit të dosjes së vlerësimit për gjyqtarin {...}, periudha e vlerësimit viti 2019”, në datën 7.1.2021, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vendosur: *“Vlerësimin e plotësisë së dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura në krijimin e dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së raportit analitik për gjyqtarin {...}. Vijimin e procedurës së vlerësimit për hartimin e projektraportit të vlerësimit...”*

Projektraporti i vlerësimit i përgatitur nga relatori, iu njoftua gjyqtarit në adresën e tij elektronike në dt. 10.02.2021. Në dt. 17.02.2021, brenda afatit 1/javor, gjyqtari konfirmoi marrjen dijeni si dhe parashtroi kundërshtimet e tij lidhur me projektraportin e vlerësimit, pa paraqitur prova të reja dhe pa kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore. Kundërshtimet e gjyqtarit u administruan në dosjen e vlerësimit dhe u vlerësuan në tërësi nga Këshilli, nga rezultoi se ato nuk afektonin propozimet e relatorit në lidhje me shkallën e aftësisë dhe pikëzimin për çdo tregues vlerësimi.

Projektraporti i vlerësimit u shqyrtua nga Këshilli në Mbledhjen Penale të dt. 01.07.2021 dhe u miratua prej tij në tërësi pa ndryshime.

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT
PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.aAftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari, në bazë të kategorisë së çështjes (padi themeli ose kërkesë administrative), përcakton në fillim të pjesës përshkuese arsytues të vendimit, faktet e çështjes të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë gjykimit. Karakteristikë e vendimeve të gjyqtarit {...} është paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit në mënyrë të qartë, të plotë dhe mbi bazën e renditjes kronologjike. Përshkrimi i rrethanave të faktit të provuara në gjykim, bëhet në çdo rast duke i ndërthurur me provat shkresore, aktin e ekspertimit dhe provat e tjera të marrë gjatë gjykimit, duke evidentuar dhe elementët e faktit që kanë rezultuar si të provuar nga vlerësimi tërësor i tyre.

Në rrethanat e faktit gjyqtari evidenton edhe ecurinë e procedimit administrativ në rast se palët kanë ushtruar ankim administrativ para ngritjes së padisë, duke evidentuar në disa raste në mënyrë të përmbledhur arsytimin e organit që ka shqyrtuar çështjen në rrugë administrative (*vendimi nr. 3941, datë 14.11.2019, vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019*) apo mungesën e veprimit nga organi administrativ palë e paditur (*vendimi nr. 3993 (4065), datë 18.11.2019*).

Pas përshkrimit të detajuar të fakteve të çështjes, kryesisht në 6 vendimet e analizuara të cilat kanë zgjidhur në themel mosmarrëveshjen dhe përbëjnë çështje me palë kundërshtare, në pjesën e parë të arsytimit të vendimit, elementë të faktit të provuar, bëhen pjesë edhe e arsytimit të gjyqtarit mbi bazueshmërinë ose jo të kërkesë padisë ose pretendimeve të palëve ndërgjyqëse. Gjyqtari, edhe pse evidenton dhe përshkruan elementë të fakteve të çështjes në pjesën e parashtrimit të pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse, pasqyron rrethanat e faktit, sikundër ai ka rezultuar nga provat e marra në shqyrtim, në mënyrë të pavarur nga ajo që palët prezantojnë.

Në një çështje e cila ka përfunduar me vendim jo përfundimtar për deklarimin e moskompetencës lëndore, për shkak të natyrës së vendimit, gjyqtari përshkruan në mënyrë të

përmbledhur vetëm faktet e çështjes të cilat kanë të bëjnë me legjitimitimin e paditësit, interesin e ligjshëm të tij në ngritjen e padisë si dhe veprimin/mosveprimin e palës së paditur që përbën shkakun e ngritjes së padisë objekt shqyrtimi (vendimi nr. 3993 (4065), datë 18.11.2019).

Në një vendim me objekt lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, faktet e çështjes përshkruhen në mënyrë të përmbledhur në një paragraf, kushtëzuar kjo nga natyra e çështjes dhe objekti i kërkesës (vendimi nr. *ska*, datë 28.5.2019).

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi menjëherë pas paraqitjes së fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse. Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet në mënyrë të qartë duke i dhënë rëndësi identifikimit në mënyrë specifike të shkakut ligjor të padisë ose kërkesës. Ai shoqërohet me konkluzionin e gjykatës lidhur me bazueshmërinë ose jo të kërtimeve që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes. Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin administrativ, titullin ekzekutiv...etj, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie, duke kërkuar sipas rastit pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, detyrimin e organit administrativ për të kryer një veprim administrativ.... etj. Përcaktimi i qartë i natyrës së mosmarrëveshjes, menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së fakteve të provuara në gjykim dhe pretendimeve të palëve, ka sjellë si pasojë në një rast konkluzionin e gjyqtarit për mungesë të kompetencës lëndore të gjykatës administrative për gjykimin e çështjes (vendimi 3993 (4065), datë 18.11.2019), ndërsa në raste të tjera ka shërbyer si bazë për orientimin e arsyetimit të gjykatës brenda kërtimeve objekt padie. Në zbatim të parimit të disponibilitetit të padisë, gjyqtari tregon kujdes që natyra e çështjes dhe kërkimet e shtruar atij për zgjidhje, të kufizohen brenda asaj që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në 7 nga 8 vendimet e vëzhguara (*përjashtim bën vetëm vendimi Nr. 2798 (2860) dt. 29.07.2019*), rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, dhe atyre materiale të parashikuara në Kodit Civil apo dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtari ka referuar dhe cituar në disa raste, si pjesë e arsyetimit të vendimit, nenet 1 pg 2, 6 dhe 28 të K.Pr.C në lidhje me rolin e gjykatës dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykimin civil (vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019); fuqinë detyruese të vendimit gjyqësor të formës së prerë sipas parashikimeve të nenit 451/a të K.Pr.C (vendimi nr. 474 (498), datë 15.2.2019); kompetencën lëndore të gjykatës administrative në raport me llojin e mosmarrëveshjes dhe shkakun ligjor të padisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 133/2015 (vendimi nr. 3993 (4065), datë 18.11.2019); cilësinë e vendimit si të paankimueshëm për shkak të vlerës së padisë sipas nenit 45 të ligjit nr.49/2012 (vendimi nr. 1610 (1651), datë 8.5.2019), etj.

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtari ka identifikuar, referuar, dhe në disa raste ka cituar dispozita të Kodit të Procedurave Administrative, Kodit Civil dhe ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjet objekt shqyrtimi.

Konkretisht, në 7 nga 8 vendimet e analizuara, referohen dispozitat të ligjit material si më poshtë :

- neni 118 i K.Pr.A lidhur me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ dhe shkaqet e pavlefshmërisë, kuptimin e parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit nga organi administrativ më i lartë(vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019).
- nenet 113-117 të K.Pr.A dhe dispozita të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimet publike”, i ndryshuar, lidhur me kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik dhe kompetencën e organit më të lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave, shfuqizimin e akteve administrative, ushtrimin e ligjshëm të diskrecionit, procedurën e prokurimit publik, etj (vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019);
- nenet 106, 109, 110 të Kodit Civil dhe nenin 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, në lidhje me mirëbesimin në marrëdhëniet juridiko civile si dhe të drejtën e dëmshpërblimit për të tretët, për pronat e kthyerat ish pronarëve. Në këtë vendim identifikohet dhe zbatohet në vlerësimin e kërtimeve objekt padie edhe qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 21.3.2000 në lidhje me elementët që duhet të merren parasysh në përcaktimin e masë së dëmshpërblimit, i cili në këtë rast, për shkak të ometimit ligjor, është zbatuar drejtpërdrejt nga gjyqtari për zgjidhjen e çështjes(vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019);
- nenin 609 të K.Pr.C në lidhje me rastet e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv (vendimi nr. 474 (498), datë 15.2.2019);
- nenet 20 dhe 63 të ligjit nr. 105/2014 lidhur me procedurën ligjore për tregtimin e barnave mjekësore (vendimi nr. 1610 (1651), datë 8.5.2019);
- nenin 22 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 lidhur me cilësinë e vendimit të dënimit me gjobë si titull ekzekutiv (vendimi nr. s’ka, datë 28.5.2019) dhe nenet 22,23,24/1 dhe 46 të po këtij ligji lidhur me cilësinë e aktit administrativ përfundimtar si titull ekzekutiv, efektet e ankimit administrativ në lidhje me pezullimin e ekzekutimit (vendimi nr. 3176, datë 1.10.2019).
- nenet 131-134 të Kodit Civil lidhur me afatin e parashkrimit të ekzekutimit, shkaqet e ndërprerjes së parashkrimit dhe momentin e fillimit të afatit të parashkrimit (vendimi nr. 3176, datë 1.10.2019);

Në disa vendime referohen si norma të zbatueshme edhe dispozita të akteve nënligjore, kryesisht lidhur me procedurën e prokurimit publik (vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019) dhe detyrimin e palës së paditur për administrimin e fondit të kompensimit për vendimet gjyqësore në lidhje me kthimin e pronave ish pronarëve (vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019).

Në një vendim janë identifikuar dhe referuar si norma drejtpërdrejt të zbatueshme nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës (vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019).

Në vendimin gjyqësor Nr. 2798 (2860) dt. 29.07.2019 gjyqtari nuk referon normat ligjore ose nënligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete, por parashtron faktin dhe arsyetimin e tij mbi bazueshmërinë e pretendimeve të palëve, vetëm mbi analizën e fakteve të çështjes, duke referuar lidhur me njërin nga prapësimet e palës së paditur, Udhëzimin nr. 15, datë 19.7.2016.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e vëzhguara nuk rezulton të jetë evidentuar konflikti i normave procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Ai ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore, që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi. Kronologjia e pasqyrimin të fakteve orjenton lehtësisht lexuesin në zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari në përputhje me rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes objekt shqyrtimi si dhe pretendimet dhe prapësimet e palëve, referon, citon në disa raste dhe interpreton norma të ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të arritura.

Përgjithësisht, në vendimet e vëzhguara normat ligjore referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes dhe në disa raste, kur është vlerësuar e nevojshme nga gjyqtari, shoqërohen me interpretim të kuptimit të tyre, para aplikimit mbi faktin konkret në shërbim të të cilit analizohen, në mbështetje të konkluzionit për zgjidhjen e çështjes.

Konkretisht, në lidhje me normat procedurale, gjyqtari ka interpretuar normat procedurale në disa raste, si më poshtë:

- interpretimi i nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me fuqinë detyruese të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe pamundësinë e gjykatës që shqyrton padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për të rivlerësuar rrethana që kanë ndodhur para se vendimi gjyqësor të marrë cilësinë e titullit ekzekutiv (vendimi nr. 474 (498), datë 15.2.2019);
- interpretimi i neneve 26 dhe 34 të ligjit nr. 133/2015 duke e lidhur me rrethanat e faktit dhe shkakun ligjor të padisë, në drejtim të vlerësimit të kompetencës lëndore të gjykatës administrative mbi çështjen objekt shqyrtimi. Interpretimi i këtyre normave shoqërohet edhe me citimin e përmbajtjes së vendimit njehsues së Gjykatës së Lartë me nr.611, datë 7.2.2018(vendimi nr. *ska*, datë 28.5.2019);
- interpretimi i neneve 6 dhe 23 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata në raport me shkakun ligjor të padisë, duke e lidhur këtë interpretim me konkluzionin e gjyqtarit për të kufizuar arsyetimin vetëm në analizën e shkave të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, duke respektuar parimin e disponibilitetit të padisë nga pala paditëse (vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019);

- interpretimi i nenit 1 të K.Pr.C në lidhje me detyrimin e gjykatës për t'u shprehur në lidhje kërkimet e objekti të padisë, për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, pavarësisht se ligji mungon, është i paqartë apo ka kundërthënie. Në këtë rast gjyqtari interpreton nenin 1 pika 2 të K.Pr.C në lidhje me detyrimin për zgjidhjen e çështjes pavarësisht mosveprimit të ligjvënësit për të miratuar një formulim të ri për nenin 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, i cili është konstatuar antikushtetues në pjesën e dytë të tij (vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019);

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, në 7 nga 8 vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtari, përveç citimit ose zbatimit të drejtpërdrejtë të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, në disa raste është ndalur edhe në interpretimin ligjor të tyre dhe më pas aplikimin mbi faktet konkrete, për të mbështetur konkluzionet e arritura lidhur me çështjen. Konkretisht rezulton të jenë interpretuar dispozitat ligjore dhe nënligjore lidhur me :

- pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ dhe shkaqet e pavlefshmërisë, duke interpretuar kuptimin e nenit 108 të K.Pr.A dhe përjasjen e kuptimit të tij me faktet e çështjes dhe pretendimet e palës paditëse si dhe kuptimin e parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit sipas nenit 11 të K.Pr.A, nga organi administrativ më i lartë (vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019);
- kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik dhe cilësinë e tij si organi më i lartë për shqyrtimin e ankesave, kompetencën për shfuqizimin e akteve të organit administrativ që ka nxjerrë vendimin objekt ankimi në procedurat e prokurimit publik. Në këtë rast gjyqtari bën interpretim ligjor të pavarur të nenit 19 i ligjit të posaçëm për prokurimin publik duke e lidhur atë me 113-117 të K.Pr.A si dhe dispozita të VKM nr. 614, datë 29.12.2014, për të vijuar më pas me aplikimin e tyre mbi faktet e çështjes dhe për të mbështetur konkluzionin e arritur mbi ligjshmërinë e aktit administrativ objekt kundërshtimi (vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019);
- mirëbesimin në marrëdhëniet juridiko civile sipas neneve 106,109,110 të Kodit Civil, efektet që sjell pavlefshmëria e veprimit juridik mbi të tretin në mirëbesim si dhe të drejtën e tij për të përfutur dëmshpërblim, për pronat e kthyera ish pronarëve sipas nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 si dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kuptimin e këtij neni si dhe situatën e krijuar nga mosveprimi i ligjvënësit për të plotësuar hapësirën e krijuar nga shfuqizimi si antikushtetues i pjesës së dytë të këtij neni (vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019);
- shkaqet ligjore të pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv sipas nenit 609 të K.Pr.C dhe shkaqet që mund të ndikojnë në vlefshmërinë e titullit në rastet kur titulli është një vendim gjyqësor dhe faktet e vendosura në themel të pretendimit për pavlefshmëri të titullit nga pala paditëse kanë ndodhur para se vendimi gjyqësor të merrte cilësinë e titullit (vendimi nr. 474 (498), datë 15.2.2019 dhe vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019);
- procedurën ligjore për tregtimin e barnave mjekësore duke interpretuar nenet 20 dhe 63 të ligjit nr. 105/2014 lidhur me detyrimin e tregtuesit me pakicë të bankave për të respektuar kushtet e ligjshmërisë së tregtimit të barnave, pavarësisht respektimit ose jo të këtyre kushteve nga furnizuesi (vendimi nr. 1610 (1651), datë 8.5.2019);
- cilësinë e aktit administrativ përfundimtar si titull ekzekutiv, efektet e ankimit administrativ në lidhje me pezullimin e ekzekutimit, sipas parashikimeve të neneve 22,23,24/1 dhe 46 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 si dhe përcaktimin e efekteve të

ankimimit administrativ të aktit të dënimit me gjobë sa i përket pezullimit të ekzekutimit të tij (vendimi nr. 3176, datë 1.10.2019).

- afatin e parashkrimit të ekzekutimit, shkaqet e ndërprerjes së parashkrimit sipas parashikimeve të neneve 131 dhe 134 të Kodit Civil si dhe momentin e fillimit të afatit të parashkrimit lidhur me vendimet administrative të dënimit me gjobë, duke e lidhur këtë interpretim me konkluzionin e gjyqtarit për pabazueshmërinë e pretendimit të palës paditëse për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të ekzekutimit (vendimi nr. 3176, datë 1.10.2019);

Në disa nga vendimet referohen, citohen pjesërisht dhe kur është vlerësuar e nevojshme janë interpretuar, dispozita të akteve nënligjore që gjejnë zbatim në rastin konkret, kryesisht lidhur me procedurën e rregullt të prokurimit publik (vendimi nr. 3941 (4016), datë 14.11.2019) dhe detyrimin e palës së paditur për administrimin e fondit të kompensimit për vendimet gjyqësore në lidhje me kthimin e pronave ish pronarëve, në shërbim të konkluzionit të arritur nga gjyqtari mbi ekzistencën e legjitimitetit pasiv të palës së paditur (vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019).

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, gjyqtari zbaton parimin e procesit të rregullt ligjor, pa përmendur shprehimisht elementë të këtij parimi, por duke iu referuar kontekstit të arsyetimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejt aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, disponibilitetin e padisë nga pala paditëse në përcaktimin e objektit të mosmarrëveshjes, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim, duke argumentuar në një rast edhe mbi vlerësimin e tij të ndryshëm lidhur me konkluzionet e arritura nga eksperti në aktin e ekspertimit (vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019).

Gjyqtari ka interpretuar dhe zbatuar parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit nga organi administrativ, parashikuar nga neni 11 i K.Pr.A (vendimi nr. 3941, datë 14.11.2019) dhe parimin e *gjësë se gjykuar* për të përcaktuar efektet detyruese të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe moscënimin e tij nga pretendimet për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv për fakte që kanë ndodhur para formimit të titullit (vendimi nr. 474 (498), datë 15.2.2019).

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante, në dy nga vendimet të analizuara, referuar objektit të mosmarrëveshjes, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në lidhje me:

- kuptimin e “shpërblimit të drejtë” sipas përcaktimeve të nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993. Në këtë vendim gjyqtari referon në kuptimin e këtij termi të ligjit konkluzionet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 21.3.2000 si dhe zbaton drejtpërdrejt orientimet e këtij vendimi në dhënien e zgjidhjes për çështjen konkrete për shkak të ometimit ligjor;
- kompetencën lëndore të gjykatës administrative për trajnimin e çështjeve ndaj Agjencisë së Trajtimit të Pronave, në zbatim të ligjit nr. 133/2015. Në këtë rast gjyqtari i referohet, në mbështetje të interpretimit të neneve 26 dhe 34 të ligjit të posaçëm, qëndrimit të Gjykatës së Lartë në vendimin njësuës nr. 611, datë 7.2.2018, lidhur me përcaktimin e kompetencës lëndore të gjykatës administrative dhe gjykatës

së juridiksionit të përgjithshëm për trajtimin e çështjeve ndaj ATP-së, në varësi të shkakut ligjor të padisë.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, në vendimet përfundimtare të analizuara, gjyqtari në disa raste dhe kur është e vlerësuar e nevojshme, ka interpretuar dispozita të akteve ligjore dhe nënligjore, me natyrë procedurale dhe materiale, duke referuar në dy raste edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Në raste të tjera dispozitat referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes pa u shoqëruar me interpretim të pavarur të tyre. Ndërsa në vendimin Nr. 2798 (2860) dt. 29.07.2019, mungon tërësisht evidentimi dhe analiza e ligjit apo aktit nënligjor të zbatueshëm. Në këtë të fundit, analiza e fakteve të çështjes pa u identifikuar së pari rregulli që përcakton kuptimin ligjor që i atribuohet këtyre fakteve, zbeh kuptueshmërinë e vendimit, pavarësisht zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Mbi mesatare", duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjithë dokumentet ligjorë, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërit prej tyre.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin. Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës, gjyqtari i përmend ato në arsyetim duke i cituar në gjuhën shqipe, pa krijuar për lexuesin konfuzion për kuptimin e tyre. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që çenojnë integritetin e personit, si dhe tregohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues, në rastet kur pretendimet e palëve nuk gjejnë bazueshmëri në ligj e prova.

Gjyqtari përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor.

Termet teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm siç është rasti i përdorimit të termave në lidhje me masën e detyrimit të akcizës (vendimi nr. 2798 (2860), datë 27.9.2019) apo në lidhje me procedurën e hedhjes

në treg të barnave mjekësore, rast në të cilin gjyqtari i referohet terminologjisë së ligjit të posaçëm nr.105/2014 (vendimi nr. 1610 (1651), datë 8.5.2019).

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë, të kuptueshëm dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, reflekton qartësi dhe thjeshtësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, duke i bërë ato të kuptueshme dhe duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gabimet gramatikore janë të papërfillshme dhe në atë masë që nuk ndikojnë në shkallën e aftësisë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se vendimet përfundimtare, në aspektin strukturor kryesisht janë ndërtuar sipas një modeli të njëjtë duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese, pjesa urdhëruese) sipas parashikimeve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile.

Pjesa hyrëse e vendimit pasqyron ekstremitetet e vendimit gjyqësor, gjykatën që ka dhënë vendimin, kohën e zhvillimit të gjykimit palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit, objektin e padisë/kërkesës, bazën ligjore si dhe kërkimet përfundimtare.

Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit nga pikëpamja formale është e organizuar në paragrafë, e pa ndarë në pjesë të veçanta dhe të dallueshme, por në përmbajtje arsyetimi i vendimit ndjek një strukturë përgjithësisht të njëjtë, në varësi të kategorisë së çështjes (çështje themeli ose kërkesë) apo natyrës së vendimit (vendim themeli ose vendim jo përfundimtar).

Në vendimet e themelit pjesa përshkruese arsyetuese e vendimit fillon me identifikimin e çështjes objekt shqyrtimi, përshkrimin e detajuar të fakteve të çështjes duke integruar provat respektive, pasqyrimin e detajuar të kërkimeve të palës paditëse dhe prapësimeve të palës së paditur, konkluzionin e gjyqtarit lidhur me bazueshmërinë ose jo të kërkimeve dhe më pas vijohet me analizën ligjore dhe parashtrimin e argumenteve lidhur me konkluzionin e arritur. Në pjesën e vlerësimit të gjyqtarit lidhur me çështjen përgjithësisht arsyetimi është i organizuar në paraqitjen e argumenteve njëri pas tjetrit duke integruar në arsyetim pjesë të

normave ligjore që gjejnë zbatim. Nga pikëpamja formale, argumentet e gjyqtarit, në shumicën e vendimeve fillojnë me e fjalët hyrëse “*Së pari, se dyti...*”, për të bërë të identifikueshëm renditjen e tyre si dhe lidhjen e argumenteve me njëri-tjetrin.

Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme duke parashtruar disponimet e gjykatës lidhur pranimin e plotë, të pjesshëm, rrëzimin e kërkesëpadisë/kërkesës ose deklarimin e mos kompetencës lëndore në një rast.

Në vendimet në të cilat është disponuar për pranimin e kërkesë padisë gjyqtari përcakton qartë detyrimin e palës së paditur lidhur me kërkimet e padisë të pranuar së bashku me përcaktimin e vlerës së tyre kur është rasti (vendimi nr. 3057 (3129), datë 24.9.2019, nr. 2798 (2860), datë 29.7.2019). Në dispozitiv pasqyrohet gjithashtu disponimi për : heqjen e masës së sigurimit të padisë për shkak të rrëzimit të kërkesë padisë në një rast (vendimi nr. 474 (498), datë 15.2.2019); ekzekutimin e vendimit nga shërbimi përmbarrimor pas marrjes formë të prerë në rastet e pranimit të padisë; shpenzimet gjyqësore sipas disponimit lidhur me objektin e padisë; të drejtën e ankimit; afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUSIONE:

Sa më sipër, rezulton se gjyqtari ndjek një strukturë përgjithësisht të njëjtë në arsyetimin e vendimeve, strukturë e cila pavarësisht se në pjesën përshkruese- arsyetuese të vendimit nuk është e ndarë vizualisht në nënpjesë, i bën vendimet të qarta, lehtësisht të lexueshme dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuar, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet e themelit është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj, provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete. Vetëm në rastin e vendimit për deklarimin e moskompetencës, gjyqtari ka parashtruar dhe analizuar faktet e çështjes vetëm sa i përket elementëve procedurale të shqyrtimit të kërkimit në rrugë administrative, për shkak se vendimi është jo përfundimtar dhe faktet që përbëjnë objektin e padisë, nuk i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor (vendimi nr. 3993 (4065), datë 18.11.2019).

Përveç paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, së bashku me provat mbi të cilat ato mbështeten, në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, fakte të caktuara dhe me rëndësi në raport me argumentet e gjyqtarit, rimerren sërish në analizë, në mënyrë të integruar me analizën e ligjit, në pjesën e arsyetimit të vendimit që përbën argumentet e gjykatës për bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt padie.

Në vendimet përfundimtare për çështjet me palë kundërshtare, gjyqtari analizon kërkimet objekt padie duke shtjelluar arsyet e konkluzionit të arritur në lidhje me padinë, sipas një analize të integruar të ligjit me rrethanat e faktit, në funksion të drejtpërdrejtë të konkluzioneve të tij.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike, duke dhënë argumente lidhur me secilin kërkim të objektit të padisë dhe duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete si dhe lidhjen shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura nga gjyqtari lidhur me kërkimet konkrete.

Në shumicën e vendimeve, posaçërisht në vendimet e themelit, gjyqtari analizon dhe lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkimet objekt padie ose pretendimet e palës së paditur, me faktin e provuar në gjykim si dhe me argumentin ligjor konkret, duke evidentuar lidhjen shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim me konkluzionin e tij për bazueshmërinë ose jo të pretendimeve nga pikëpamja ligjore.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, gjyqtari përgjithësisht i kushton vëmendje pretendimeve dhe prapësimeve që ai i konsideron të bazuara në ligj dhe në prova në mbështetje të zgjidhjes së çështjes. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, jo në një pjesë të veçantë të arsytimit, por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, këto të fundit marrin përgjithësisht një përgjigje të argumentuar, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit të vendimit. Por cilësia e analizës referuar pretendimeve dhe prapësimeve kundër zgjidhjes së çështjes nga gjyqtari, nuk ka të njëjtën shkallë argumentimi për të shpjeguar mungesën e relevancës së duhur në ligj apo fakte të provuara, krahasuar me ato që gjyqtari i ka vlerësuar të bazuara.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, në vendimet gjyqësore të analizuara, cilësia e analizës ligjore dhe argumentimit logjik përmbush standardet e procesit të rregullt ligjor. Ajo është ezauruese lidhur me kërkimet objekt padie, por jo gjithmonë gjithëpërfshirëse për analizën e pretendimeve të kundërta.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “mbi mesataren” duke e pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjithë dokumentet ligjorë, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërit prej tyre.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
90	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 10 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin dy kategorive, “administrative me palë kundërshtare” dhe “administrative pa palë kundërshtare”. Duke iu referuar objektit të çështjeve pasqyruar në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet janë me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbardimore” për të cilat neni 610 paragrafi i tretë¹ i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se çështja duhet të shqyrtohet brenda një afati 20 ditor, dhe me objekt “Sigurim padie”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 28 pika 3² të ligjit nr. 49/2012 duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë.

Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se nga 10 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 8 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (8 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (10 çështje), sipas një analize vetëm matematikore, gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 80 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari i gjykatës parashitrojnë se ligji i posaçëm nuk parashikon afat ligjor për përfundimin e gjykimit të çështjeve në gjykatën administrative dhe se gjyqtari ka respektuar në çdo rast afatin e arsyeshëm të gjykimit sipas

¹Neni 69 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se “Veprimet e kryerja nga përmbarduesi gjyqësor, në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen sipas parashikimeve të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile.”. Ndërkohë neni 601 pg 3 i K.Pr.C parashikon se :”Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbarduesin gjyqësor.”.

²Neni 28 pika 3 i ligjit nr. 49/2012 « «Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative » parashikon se « «3.Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në rastet e ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. »

parashikimeve të nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile. Gjyqtari parashtrohet gjithashtu se vonesat në shqyrtimin e çështjeve kanë ardhur në disa raste si pasojë e shortimit me vonesë të tyre.

Në detyrën e vlerësuesit është bërja e analizës së të dhënave statistikore në mënyrë të tillë që të shmangen përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat e burimeve të tjera të vlerësimit.

Duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, për 8 çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor, rezulton se çështjet me objekt “kundërshtim veprimesh përmbarimore”, përbëjnë 4 prej tyre, për të cilat afati ligjor 20 ditor i gjykimit, nga data e regjistrimit në gjykatë deri në datën e shpalljes së vendimit, është tejkaluar nga 8 deri në 36 ditë ose më një mesatare prej 25 ditësh.

Analiza e kohëzgjatjes së secilës prej çështjeve, duke vlerësuar argumentat e dhëna në Formularin e Integruar të Vlerësimit për shortimin me vonesë të çështjeve, rezulton si më poshtë:

- Çështja me nr.2144 akti, datë regjistrimi 25.3.2019, përfunduar me vendimin nr. 1588, datë 14.5.2019, është shortuar më datë 26.3.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes sërish rezulton të ketë përfunduar jashtë afatit ligjor 20 ditor dhe konkretisht për 1 muaj e 18 ditë.
- Çështja me nr.2749 akti, datë regjistrimi 6.5.2019, përfunduar me vendimin nr. 1901, datë 3.6.2019, është shortuar më datë 7.5.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes sërish rezulton të ketë përfunduar jashtë afatit ligjor 20 ditor dhe konkretisht për 27 ditë.
- Çështja me nr.2478/121 akti, datë regjistrimi 12.4.2018, përfunduar me vendimin nr. 1980, datë 7.6.2019, është shortuar më datë 13.4.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes sërish rezulton të ketë përfunduar jashtë afatit ligjor 20 ditor dhe konkretisht për 1 muaj e 25 ditë.
- Çështja me nr.4438 akti, date regjistrimi 26.8.2019, përfunduar me vendimin nr. 3414, datë 15.10.2019, është shortuar më datë 2.9.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes sërish rezulton të ketë përfunduar jashtë afatit ligjor 20 ditor dhe konkretisht për 1 muaj e 13 ditë.

Në total afati ligjor për çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”, nëse ai do të llogaritej nga data e shortit deri në datën e shpalljes së vendimit, rezulton të jetë tejkaluar mesatarisht me 23 ditë.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore” neni 610 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ato shqyrtohen në dhomë këshillimi, dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e afatit deri në 10 ditë sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja « a » të ligjit nr.49/2012 ;
- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbaruesit gjyqësor dhe lënien e afatit deri në 10 ditë për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave, sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja « b » të ligjit nr.49/2012;
- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t'u dëgjuar në seancë.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, pa përlloritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbaruesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji.

Në çështjet me objekt “sigurim padie”, nga 5 çështje, 4 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor pesë ditor, duke u tejkaluar ky afat nga 2 deri në 6 ditë. Nëse i referohemi datës së regjistrimit dhe asaj të shortimit të çështjeve, sipas të dhënave statistikore të pasqyruara në tabelën nr.2, rezulton se çështjet janë shortuar në disa raste me disa ditë vonesë nga momenti i regjistrimit të tyre në gjykatë, shkak ky që parashtrohet edhe nga gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit.

Konkretisht, lidhur me datën e shortimit të çështjeve, rezulton si më poshtë:

- Çështja me nr.41 akti, date regjistrimi 13.3.2019, përfunduar me vendimin nr. *ska*, datë 21.3.2019, është shortuar më datë 15.3.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes sërish rezulton të ketë përfunduar jashtë afatit ligjor 5 ditor dhe konkretisht për 6 ditë, ndërkohë që data e shortit ka qenë ditë e premte dhe datat 16 dhe 17 janë ditë pushimi (e shtunë dhe e diel).
- Çështja me nr.58 akti, date regjistrimi 13.5.2019, përfunduar me vendimin nr. *ska*, datë 20.5.2019, është shortuar më datë 14.5.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes sërish rezulton të ketë përfunduar jashtë afatit ligjor 5 ditor dhe konkretisht për 6 ditë, ndërkohë që dita e pestë që përkon me datën 19.5.2019 ka qenë ditë e diel dhe çështja ka përfunduar në ditën e parë që vjen pas saj.
- Çështja me nr.119 akti, date regjistrimi 11.10.2019, përfunduar me vendimin nr. *ska*, datë 18.10.2019, është shortuar më datë 14.10.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes rezulton të ketë përfunduar për 4 ditë, brenda afatit ligjor 5 ditor.
- Çështja me nr.139 akti, date regjistrimi 25.11.2019, përfunduar me vendimin nr. *ska*, datë 6.12.2019, është shortuar më datë 26.11.2019. Nëse afati ligjor do të fillonte në datën e shortit, gjykimi i çështjes sërish rezulton të ketë përfunduar jashtë afatit ligjor 5 ditor dhe konkretisht për 10 ditë, ndërkohë që gjatë këtij afati datat 28 dhe 29 nëntor kanë qenë ditë pushimi zyrtar dhe datat 30 nëntor dhe 1 dhjetor kanë qenë ditë pushimi (e shtunë dhe e diel). Pra nga 10 ditë, 4 ditë kanë qenë ditë pushimi.

Nëse do të konsiderohej si momenti i fillimit të afatit ligjor të gjykimit data e shortit për këto 4 çështje, për një³ prej tyre afati i shqyrtimit nga data e shortit deri në datën e dhënies së vendimit është 4 ditë, pra brenda afatit ligjor. Ndërsa për tre çështjet e tjera, afati ligjor i gjykimit është tejkualuar përkatësisht me 1 ditë në dy çështje⁴ dhe me 5 ditë në një çështje⁵.

Pra, nëse afati ligjor do të llogaritej nga data e shortit, duke qenë se shortimi i çështjeve në kohë nuk është përgjegjësi e gjyqtarit, rezultojnë vetëm 3 çështje me objekt “Sigurim padie” të shqyrtuara jashtë afatit 5 ditor, afat në të cilin, sikurse rezultoi janë përfshirë edhe ditë pushimi javor ose ditë pushimi të festave zyrtare (28 dhe 29 nëntori) të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e çështjeve. Nëse këto ditë do të përfshihen në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve, rezulton se në tre çështje afati ligjor i gjykimit është tejkualuar me 1 ditë në 2 çështje dhe me 4 ditë në një çështje, me një mesatare prej 2 ditësh. Nëse ditët e pushimit javor apo festave zyrtare nuk do të përfshihen në kohëzgjatjen e gjykimit, do të rezultonte vetëm një çështje nga kjo kategori e përfunduar për 6 ditë, duke tejkualuar me vetëm 1 ditë, afatin ligjor të gjykimit, ndërsa dy çështjet e tjera kanë përfunduar përkatësisht për 4 dhe 5 ditë pune, brenda afatit 5 ditor të shqyrtimit. Për këtë arsye, çështjet për të cilat afati i shqyrtimit, nga data e shortimit, ka kaluar vetëm me 1 ditë, pra kanë përfunduar për 6 ditë dhe në të cilat rezulton se brenda këtij afati përfshihen 1 ose 2 ditë pushimi, nuk konsiderohen çështje të përfunduara jashtë afatit ligjor.

Sa më sipër, duke përjashtuar kohën nga momenti i regjistrimit të çështjes deri në datën e shortimit të saj, si dhe çështjet që kanë tejkualuar vetëm më një ditë afatin ligjor të gjykimit ndërkohë që janë përfshirë në këtë afat edhe ditë pushimi, nga 10 çështje me afat ligjor, vetëm 4 prej tyre ose 40 % rezultojnë të kenë përfunduar tej këtij afati, duke u tejkualuar afati mesatarisht me 23/ditë për 4 çështje të kategorisë “administrative me palë kundërshtarë” (kundërshtim veprimesh përmbarimore).

Përqindja e mësipërme sipas Metodologjisë pikëzohet me 6 (gjashtë) pikë. Por në Metodologji është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si : kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konkretisht :

- a) numrit të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor në raport me numrin e çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor (nga 10 çështje në total, vetëm 4/çështje me mesatare tejkalimi 23/ditë) ;
- b) kohës relativisht të shkurtër të tejkalimit të afatit ligjor në shumicën e çështjeve të analizuara sipas të dhënave statistikore, e cila gjithsesi e llogaritur bashkë me kohën e shqyrtimit, mesatarisht është më e vogël se 45 ditë, brenda të cilës mund të përfundojë gjykimi i së njëjtës çështje në gjykatën e apelit. Ligji procedural parashikon për shkallën e

³ Çështja me numër rendor 162 në tabelën nr. 2.

⁴ Çështjet me numër rendor 159 dhe 160 në tabelën nr. 2.

⁵ Çështja me numër rendor 163 në tabelën nr. 2.

parë shqyrtimin e ankimit ndaj veprimeve përmbarimore brenda 20/ditëve, si rregull në dhomë këshillimi. Gjykatës i njihet mundësia e thirrjes së palëve kur e vlerëson të nevojshme. Por ligji nuk parashikon afat për gjykatën e shkallës së parë, sikundër bën në rastin e gjykimit në apel, për shqyrtimin e çështjes kur ajo kalon në seancë gjyqësore. Kjo situatë ligjore nuk mund të anashkalohej nga vlerësuesi, në rastet kur afati i gjykimit i çështjeve të kësaj kategorie, në shkallën e parë, tejkalon afatin 20/ditor, por është më i shkurtër se 45/ditë ;

- c) pamundësinë e respektimit në të gjitha rastet të afatit ligjor 20/ditor sipas nenit 610 të K.Pr.C, për shkak të veprimeve procedurale të nevojshme për t'u kryer në kuadër të gjykimit administrativ, me qëllim respektimin e të drejtave dhe detyrave procedurale të organit publik (personit fizik apo juridik që ofron një shërbim publik) ;

vlerësohet se për këtë tregues, gjyqtari duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton 40%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarit, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 9 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, duke iu referuar standardit minimal kohor 1 mujor të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010⁶ të KLD-së, rezulton se nga 472 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 274 prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë 58 % të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Vlerësimit kanë bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën administrative të tilla si ngarkesa e lartë, kompleksiteti i çështjeve, koha e nevojshme për studimin dhe gjykimin e tyre, veprimet procedurale të nevojshme dhe të domosdoshme për tu kryer gjatë gjykimit, natyra e kërkimeve dhe pretendimeve të palëve gjatë gjykimit, papërshtatshmëria dhe mungesa e koherencës së afatit 1 mujor të përcaktuar në vendimin nr.261/2 të KLD-së me parashikimet e ligjit nr.49/2012 që përcakton afatet brenda të cilave duhet të kryhen veprimet procedurale në gjykimin administrativ, etj.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit ose kërkesave pa palë kundërshtare, përveç parashikimeve të afatit ligjor të gjykimit për kërkesa të posaçme të tilla si kërkesa për sigurimin e padisë për të cilën neni 28 pika 3 i

⁶Në pikën 5 shkronja "c" të "Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore", miratuar me vendimin e KLD nr. 261/2 të vitit 2010, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative, parashikohet se : " Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë: ...c. Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo me tej se 1 muaj.".

ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 5 ditor të shqyrtimit apo çështje të tjera administrative të cilat, sipas ligjeve të posaçme, duhet të shqyrtohen brenda një afati të përcaktuar.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatin mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.C për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orjentues ende në fuqi.

Në këtë rast respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodit i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 muaj nga ajo e përcaktuar si standard orjentues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim. Referuar afatit 87/ditor të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 472 çështje të gjykuara për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje matematikore, vetëm 96 prej tyre ose 20 % e çështjeve, kanë përfunduar përtej këtij afati.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 4/pikë. Por referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjesi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi

sasior i punës së gjyqtarit. Gjyqtari ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 481 çështje, pra 220 % më shumë se treguesi sasior i përcaktuar në Vendimin Nr.261/2 të vitit 2010.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87 ditor dhe jo 1 muaj ;
- b) raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 20 % ;
- c) shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sikurse është ngarkesa e lartë pasi rezulton se gjyqtari ka përfunduar gjatë gjithë vitit 481 çështje, pra 331 çështje ose 220% më tepër se standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 20 % të çështjeve jashtë standardit minimal 87/ditor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së tij (481 çështje të përfunduara me vendim).

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi (1 muaj) sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi për dy nga tre kategoritë e çështjeve.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare” është 2 muaj e 26 ditë (më e gjatë se standardi minimal kohor në fuqi); për kategorinë “çështje administrative pa palë kundërshtare” është 11 ditë (më e shkurtër se standardi); dhe për kategorinë “marrëdhënie pune” është 2 muaj e 15 ditë (më e gjatë se standardi).

Duke iu referuar arsyetimit të mësipërm lidhur me standardin minimal që duhet të gjejë zbatim për gjykimin e të gjitha çështjeve administrative, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të tre kategoritë e çështjeve, është më e shkurtër se afati 87 ditor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, kanë renditur një sërë shkaqesh që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimeve administrative në përgjithësi, për pasojë edhe në treguesin e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje, të tilla si kompleksiteti i çështjeve, koha e pushimeve vjetore në muajin gusht të çdo viti, ngarkesa e lartë e gjyqtarëve, kërkesat procedurale të palëve, respektimit i të drejtave të tyre, sjellja e palëve ndërgjyqëse, etj.

Për sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të tre kategoritë, me afatin 87 ditor të pranuar si një standard minimal për një gjykim administrativ, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONE:

Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (*treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.”*), duke konsideruar afatin 87 ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është e lartë, pasi për të tre kategoritë e çështjeve, koha mesatare është me shkurtër se ky afat.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin administrativ, për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik, është 93 %.

Në Formularin e Vlerësimit gjyqtari ka parashtruar se në rendimentin e përfundimit të çështjeve kanë ndikuar ngarkesa e lartë në punë si dhe kohëzgjatja e pesë çështjeve të cilat janë pezulluar duke ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të tyre⁷. Kryetari i gjykatës parashtron të njëjtat arsye që kanë ndikuar në rendimentin e përfundimit të çështjeve duke e vlerësuar aftësinë e gjyqtarit për këtë tregues shumë të lartë dhe duke parashtruar se për vitin 2019 nuk rezulton që gjyqtari të ketë mbartur çështje pa palë kundërshtare në vitin 2020.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, rendimenti llogaritet si raport mes numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda një viti kalendarik. Për këtë arsye, numri i çështjeve të pezulluara gjatë periudhës apo të mbartura nga viti i mëparshëm, nuk ndikon në llogaritjen e rendimentit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 6/pikë. Por referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjesi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka

⁷ Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit identifikon si çështje të pezulluara çështjet me nr. regjistri themelar 2169, 2094, 2121, 3170 dhe 3853.

gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 150 çështje. Gjyqtari ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 481 çështje, pra 220 % më shumë se treguesi sasior i mësipërm.

KONKLUSIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2019, 481 çështje, pra 331 çështje ose 220% më tepër se standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së⁸, vlerësohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtari, pavarësisht se rezulton të jetë 93 %, duhet të pikëzohet me 10 pikë referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarit lidhen me ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 10 pikë, pasi rendimenti prej 93 % i përfundimit të çështjeve ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së tij (481 çështje të përfunduara me vendim, ose 220 % më shumë se standardi sasior i punës).

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 42 pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

Në çështjet e kategorisë “administrative me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 7.9 ditë;

Në çështjet e kategorisë “administrative pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 8 ditë;

Në çështjet e kategorisë “marrëdhënie pune” koha mesatare e arsytimit të vendimit është 9.5 ditë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari ka parashtruar se shumica e vendimeve të tij janë arsyetuar brenda afatit ligjor. Gjithashtu ai parashtron se vendimet e dorëzuara në datën 8.7.2019⁹ janë dorëzuar me vonesë pasi ka qenë 2 javë me raport shëndetësor dhe në kohën e

⁸ Në “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, lidhur me standardin sasior të punës, në pikën 3 shkronja “c” parashikohet se :” Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë:.. c. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrativ, jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.”.

⁹ Në tabelën nr.1 rezultojnë 10 vendime të dorëzuara në datë 8.7.2019, me afat arsytimi 17 deri në 20 ditë, në tabelën nr. 2 rezulton 1 vendim i dorëzuar në këtë datë me afat arsytimi 10 ditë dhe në tabelën nr.3

arsyetimit të vendimeve ndikon volumi i lartë i çështjeve, kompleksiteti i tyre i cili kërkon kohë dhe thellim me qëllim arsyetimin cilësor të vendimeve. Të njëjtat shkaqe të përgjithshme që diktojnë kohën e arsyetimit të vendimeve parashtrihen edhe nga kryetari i gjykatës lidhur me këtë tregues.

Nëse 10 çështjet e dorëzuara në datë 8.7.2019, për të cilat gjyqtari parashtron se janë arsyetuar me vonesë për shkak të qenies me raport shëndetësor, do të ishin arsyetuar brenda afatit maksimal 7 ditor, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar për këtë kategori (administrative me palë kundërshtare) do të rezultonte 7.6 ditë, duke tejkaluar afatin e arsyetimit me vetëm 0.6 ditë.

Ndërkohë për kategorinë “marrëdhënie pune”, nëse dy vendime të dorëzuara më datë 8.7.2019 do të ishin dorëzuar brenda afatit maksimal 7 ditor, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor për këtë kategori do të ishte 7.6 ditë, duke tejkaluar afatin e arsyetimit me vetëm 0.6 ditë. Ndërkohë për çështjet administrative pa palë kundërshtare, afati i arsyetimit është 8 ditë, pra i tejkaluar vetëm me 1 ditë.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton :

- në një rast, dorëzimi me vonesë i 12 vendimeve gjyqësore (10 të përfshira në tabelën nr.1 dhe 2 në tabelën nr. 3) ka ardhur për shkak se gjyqtari ka qenë me raport shëndetësor dhe nëse këto vendime do të ishin dorëzuar brenda afatit 7 ditor, koha mesatare e arsyetimit të vendimit për 2 nga tre kategoritë e çështjeve do të rezultonte e tejkaluar me vetëm 0.6 ditë ndërsa për të tre kategoritë së bashku koha mesatare e arsyetimit do të rezultonte e tejkaluar me 0.7 ditë, tejkallim ky pothuajse i papërfillshëm (< 1 ditë);
- afati 7 ditor i arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar i përcaktuar në nenin 42 pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është shumë i shkurtër krahasuar me afatin 20 ditor të arsyetimit për vendimet gjyqësore civile sipas parashikimeve të nenit 308 pg 2 i Kodit të Procedurës Civile (pas ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017). Edhe pse ligji nr. 49/2012 përbën ligj të posaçëm dhe sipas nenit 1 pika 2 të tij, dispozitat e K.Pr.C zbatohen vetëm në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në të, përsëri duket se pas ndryshimeve të K.Pr.C dhe shkaqeve që kanë çuar ligjvënësin në përcaktimin e afatit 20 ditor të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka një mungesë harmonizimi mes qëllimit të parashikimit të këtij afati me afatin e arsyetimit të parashikuara në ligjin nr.49/2012.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, vlerësohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor për të tre kategoritë e çështjeve duhet të konsiderohet e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, pasi tejkallimi i këtij afati nga 0,6 deri në 1 ditë, është i papërfillshëm.

rezulton 1 vendim i dorëzuar në këtë datë me afat arsyetimi 19 ditë. Gjithsej në datën 8.7.2019 rezulton të jenë dorëzuar 12 vendime të dorëzuara jashtë afatit 17 ditor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe Raportit Analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjyqësorëve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, të dhënat e analizuarat i referohen 5 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim të cilat janë çështje me palë kundërshtare. Referuar Raportit Analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për këto 5 çështje është 2.6 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët ;
- Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimi i ekspertit; lënia kohë për kryerjen e aktit të ekspertimit, shtesës së tij ose kryerjen e aktit në dy variante; dhënien kohë palës së paditur për të paraqitur prapësime dhe prova; dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar në referim të parashikimeve të nenit 302 të K.Pr.C; shtyrja e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar sipas parashikimeve të nenit 42 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012, etj.
- Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla (*afati 5 ditore për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar, afati 5 ditore për shpalljen e vendimit të arsyetuar*).
- Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave për kryerjen e veprimeve përgatitore, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, konstatohet respektimi në çdo rast i afatit ligjor për caktimin e seancave (*afati 7 ditore për zhvillimin e veprimeve paraprake sipas parashikimeve të nenit 25 të Ligjit nr.49/2012, afati 15 ditore për caktimin e seancës gjyqësore sipas nenit 27 të Ligjit nr.49/2012, afatet 10 ditore për dhënien kohë palës paditëse për plotësimin e të metave dhe palës së paditur për paraqitjen e prapësimeve dhe provave pas njoftimit të padisë*) dhe afati i arsyeshëm,

më i shkurtër se 15 ditë, për caktimin e seancave në rastet kur ligji nuk ka parashikuar afat.

KONKLUZIONE:

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 5 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.6 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e në kohë dhe me efektivitet të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2.6 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, dhe në çdo rast brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e shortit në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.49/2012.

Në 5 dosjet e vëzhguara për çështjet me palë kundërshtare, rezulton se seanca e parë për kryerjen e veprimeve përgatitore, sipas parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, është zhvilluar brenda harkut kohor nga 2 deri në 4 ditë nga momenti i shortimit.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtari kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1 të Ligjit nr.49/2012 duke disponuar për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afatit ligjor 10 ditor, duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25 pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 49/2012. Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim dhe provave, gjyqtari ka zhvilluar veprimet përgatitore duke evidentuar në procesverbal veprimet e kryera për verifikimin e njoftimeve drejtuar palës së paditur, datën e komunikimit të tyre, paraqitjen ose jo të prapësimeve me shkrim nga pala e paditur brenda afatit të caktuar nga gjykata, caktimin e një afati të ri për paraqitjen e prapësimeve dhe provave për të paditurin sipas parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, liston provat shkresore të paraqitura nga pala si dhe disponon për caktimin e seancës përgatitore duke evidentuar shkaku për caktimin e seancës përgatitore. Në dosjet e vëzhguara, në çështjet me palë kundërshtare (dosja 1,2,3,5 dhe 6) në

çdo rast është vlerësuar nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi si dhe për të marrë në shqyrtim çështje të kompetencës (dosja 5), vlerësuar nevojat e ekspertimit (dosja 1), kalimin e çështjes në seancë në dhomë këshillimi referuar natyrës së kërkesës objekt shqyrtimi, sipas parashikimeve të nenit 511 të K.Pr.C (dosja 4), etj.

Në një rast në të cilin kërkesëpapia përmban edhe kërkesën për pezullimin e veprimeve përmbartimore deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari ka caktuar, pas zhvillimit të veprimeve përgatitore, seancë gjyqësore të posaçme për shqyrtimin e kërkesës brenda afatit 5 ditor të përcaktuar në nenin 28, pika 3 të ligjit nr. 49/2012, seancë e cila është zhvilluar në prezencë të palëve dhe në përfundim të të cilës gjyqtari ka disponuar me vendim të arsyetuar për kërkesën e palës paditëse (çështja me nr. regjistri 4001, datë regjistrimi 22.6.2018, nr. vendimi 474(498), datë 15.2.2019). Në një çështje e cila i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare, me objekt “Lëshimin e urdhrat të ekzekutimit”, seanca për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi është caktuar 1 ditë pas zhvillimit të veprimeve përgatitore nga gjyqtari.

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relatimin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Në rastet kur seanca përgatitore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, gjyqtari, pasi ka dëgjuar palën paditëse, ka relatuar prapësimet me shkrim të paraqitura nga të paditurit dhe provat shkresore që janë paraqitur nga pala në mungesë, duke disponuar me vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë. Në seanca përgatitore janë shqyrtuar dhe është disponuar me vendim të ndërmjetëm, duke referuar bazën ligjore dhe arsyet përkatëse, kërkesat procedurale të palëve lidhur me shtimin e ndërgjyqësisë në bazë të nenit 161 të K.Pr.C (dosja 1), nevojën e ekspertimit duke disponuar me vendim për caktimin e ekspertit, caktimin e detyrave, nevojën e plotësimit të aktit dhe kryerjen e ekspertimit në dy variante, sipas parashikimeve të nenit 224/a e vijues të K.Pr.C (dosja 1), etj. Gjithashtu në seancë përgatitore, në një rast (dosja 4) gjyqtari ka marrë në shqyrtim dhe ka disponuar për çështje të kompetencës lëndore të gjykatës, në referim të parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 158/a të K.Pr.C, duke marrë vendim për deklarimin e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes.

Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.C, në çështjet me palë kundërshtare, gjyqtari ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila në çdo rast, në 4 çështjet e vëzhguara (dosja 1,2,3,6) është caktuar brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 3 të ligjit nr.39/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio. Seancat gjyqësore rezultojnë të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.C dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo të dijenit për palët që nuk janë paraqitur;

deponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit; dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare duke i dhënë kohë sipas afatit procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.C; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar ose shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 42 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 (dosja 1, 2).

Në disa raste, lidhur me disponimin më vendim të ndërmjetëm për kërkesat e palëve të paraqitura bashkë më padinë ose gjatë gjykimit, gjyqtari ka zbardhur të arsyetuar vendimin gjyqësor, duke e bërë pjesë të dosjes sikurse është rasti i vendimit për caktimin e detyrave të ekspertit dhe disponimit për kërkesën për sigurimin e padisë (dosja 1).

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë përgjithësisht të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat e palëve lidhur me ndërgjyqësinë, saktësimin e objektit të padisë, shtyrjen e seancës, caktimin e detyrave të ekspertit*).

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesa të papërfillshme, shoqëruar me relatimin e shkakut që ka shkaktuar vonesën. Veprimet përgatitore dhe seancat përgatitore janë dokumentuar rregullisht dhe në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore ndërsa seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë" dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me aktin e regjistrimit të çështjes në gjykatë, procesverbalin e shortit, padinë dhe provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (kur prapësimet janë paraqitur me shkrim), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet e njoftimit, procesverbalet e seancave të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të zbardhura, vendimin gjyqësor përfundimtar, vendimin për pranimin e ankimit në rastet kur palët kanë paraqitur ankim, aktet e njoftimit të vendimit dhe procesverbalin me shkrim ose audio të seancave gjyqësore. Mënyra e renditjes së akteve në dosje e bën atë lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë.

KONKLUSIONE:

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (padija, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (aktet e shortit, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e dokumentimit të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare dhe të ndërmjetme kur ato janë zbardhur me vete, vendimet për pranimin e ankimit).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për gjyqtarin {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtarit rezulton të jenë paraqitur dy ankesa për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 895/3 prot, datë 6.11.2020 dhe nr. 1527/3 prot¹⁰, datë 20.9.2020 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

Ankesa e shoqërisë “Friends” shpk, depozituar në KLGJ me nr. 1334 prot, datë 28.2.2019, regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr. 895 prot, datë 4.6.2020, konsiston në pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit material, arsyetim kontradiktor dhe provueshmërinë e fakteve dhe kërkimeve objekt padie në çështjen administrative me nr. 5108/410 (6699) në të cilën ankuesi ka qenë palë paditëse, përfunduar me vendimin nr. 163 (176), datë 25.1.2019 të gjyqtarit {...}.

¹⁰ Vendimet për verifikimin e ankesave janë dërguar nga ILD me shkresat me nr. 2437/4 prot, datë 9.11.2020 dhe nr. 2437/11 prot, datë 24.11.2020 dhe i përkasin ankesave të shtetasit K.H dhe shoqërisë “Friends”.

ILD, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka vlerësuar se pretendimet e ankuesit lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit material gjatë gjykimit dhe në vendimin përfundimtar, pretendime të cilat zgjidhen nëpërmjet mjeteve të ankimit të parashikuara nga ligji procedural. Pas këtij vlerësimi si dhe pas referimit të faktit se vendimi gjyqësor është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit dhe është në pritje të gjykimit, ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr. 895/3 prot, datë 6/11/2020 duke arsyetuar se: *“Në referim të dispozitave që parashikojnë shkeljet disiplinore të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në përmbajtje të ankesës nuk rezultojnë shkelje me natyrë disiplinore në dhënien e këtij vendimi, të parashikuara shprehimisht në nenet 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë vlerësohet se ankesa nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, kjo referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara dhe parashikimeve të nenit 120. Pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016, dhe për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121 pika 2, shkronja “a” të këtij ligji.”*

Ankesa e dytë depozituar në rrugë elektronike pranë KLGJ nga shtetasi Kudret Hasankolli, me datë 4.10.2019, është përcjellë pranë Zyrës së ILD duke u regjistruar me nr. 1527 prot, datë 6.7.2020. Ankuesi parashtron pretendimet e tij për disa subjekte ndër të cilët edhe gjyqtari {...} i cili, sipas tij, nuk i ka dhënë shtetësinë shqiptare. ILD në verifikimet e kryera lidhur me pretendimet e ankuesit, konstaton se ankesa është e përsëritur pasi rezulton se e njëjta ankesë është trajtuar nga ILD duke u vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar me vendimin nr. 1203/3 prot, datë 8.9.2020. Duke konstatuar se ankesa nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë pasi është trajtuar më parë, ILD me vendimin nr. 1527/3 prot, datë 29.9.2020 ka vendosur arkivimin e saj. Referuar vendimit nr. 1203/3 prot, datë 18.9.2020, dërguar nga ILD me shkresën nr. 537/1 prot, datë 3.2.2021, rezulton se ankesa e shtetasit Kudret Hasankolli ka paraqitur ankesa për disa gjyqtarë, ndër të cilët edhe gjyqtari {...}, duke pretenduar se ai nuk i ka dhënë shtetësinë shqiptare gjatë një procesi gjyqësor që ka patur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Lidhur me këtë ankesë, ILD ka vlerësuar se shkaqet e bëra prezent nga ankuesi lidhen me themelin e vendimit përfundimtar të gjyqtarit të cilat zgjidhen mbi bazë ankimi nga gjykata më e lartë e cila rezulton të ketë lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Në tërësi ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarit në periudhën e vlerësimit, pasi janë verifikuar nga ILD, nuk rezulton të kenë elementë të cilët mund të çenojnë etikën në punë të gjyqtarit pasi pretendimet e ankuesve lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit apo zgjidhjen në themel të çështjes, e cila është objekt i kontrollit vetëm nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit nga gjykata më e lartë.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONE:

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cënimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive,

gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jetë regjistruar pranë ILD-së dy ankesa, trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 895/3 prot, datë 6.11.2020 dhe nr. 1527/3 prot¹¹, datë 20.9.2020 më të cilët është arkivimi i ankesave, pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se nuk plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtëtin dhe pritshmëritë e publikut.

Gjithashtu nuk rezulton që ndaj gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar asnjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.195/94 prot., datë 25.6.2020, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme cenim të nderit dhe dinjtëtit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

¹¹ Vendimet për verifikimin e ankesave janë dërguar nga ILD me shkresat me nr. 2437/4 prot, datë 9.11.2020 dhe nr. 2437/11 prot, datë 24.11.2020 dhe i përkasin ankesave të shtetasit K.H dhe shoqërisë “Friends”.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të çënojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që çënojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe vlerësimi i kryetarit të gjykatës.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit nga palët dhe për pasojë, nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e tij nga gjykimi. Ndërkohë rezulton se gjyqtari ka paraqitur kërkesë për heqje dorë në tre raste, të cilat janë pranuar nga kryetari i gjykatës.

Për këto arsye, për këtë tregues, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”, duke qenë se nuk rezulton asnjë kërkesë e paraqitur dhe pranuar për përjashtimin e tij nga gjykimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i drejtpërdrejtë, i qartë, transparent, i kuptueshëm duke respektuar të drejtat e palëve në proces dhe duke treguar kujdes për të treguar trajtim të barabartë dhe me dinjitet të tyre. Gjithashtu, rezulton komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të orientuar debatin gjyqësor apo qartësuar kërkimet e palëve, komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe korrekt në lidhje me çështjet për të cilat pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Në komunikimin shkresor me subjektet palë ose jo në procesin gjyqësor, gjuha e përdorur është korrekte, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe vlerësimin e kryetarit lidhur me këtë tregues.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësi në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtari vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë patur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicje për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të palëve apo pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së

vlerësimit. Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtari ka komunikim korrekt me stafin e gjykatës.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në 6 aktivitete trajnuese, të cilat janë pjesë e Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në aktivitetin trajnues

të datave 11-12 nëntor 2019 më temë “*Kundërvajtjet administrative; Standardet kushtetuese e ligjore në kundërvajtjet administrative; Procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të tyre, vendimet për kundërvajtjet administrative, ankimi kundër këtyre vendimeve dhe ekzekutimi i tyre; Dallimi nga kundërvajtja penale.*”, gjyqtari {...} rezulton të ketë marrë pjesë në cilësinë e lehtësuesit.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9¹² të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Sa më sipër, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë, gjatë periudhës një vjeçare të vlerësimit në 6 aktivitete trajnuese të cilat përbëjnë 14 ditë trajnimi.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtari ka marrë pjesë në 6 aktivitete trajnuese të shtrira në 14 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e tij dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës administrative dhe gjyqimit administrativ.

KONKLUZIONE:

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 6 aktivitete trajnuese të shtrira në 14 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime është brenda kufijve minimale dhe maksimale nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019) duke u pikëzuar me 20 pikë.

¹²Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari {...}, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në një aktivitet trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e lehtësuesit, aktivitet i zhvilluar në datat 11 dhe 12 nëntor 2019. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e tij në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera, edhe pse ai është pjesë e listës së lehtësuesve të miratuar nga SHM në kuadër të trajnimit vazhdues për vitin 2019.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, *pavarësisht nga frekuenca e angazhimit*, vlerësohet se për gjyqtarin {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për përfshirjen e tij në listën e lehtësuesve të trajnimit vazhdues pranë SHM dhe angazhimin konkret të tij në cilësinë e lehtësuesit në një aktivitet trajnues gjatë periudhës së vlerësimit në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me zero pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE

NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	90	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	377	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...}, pavarësisht ngarkesës së çështjeve, duhet të organizojë punën dhe menaxhojë kohën, duke i dhënë prioritet shqyrtimi, çështjeve për të cilat ligji parashikon afat brenda të cilit ato duhet të gjykohen. Gjyqtari duhet të mbajë në konsideratë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese që sjellin rritje profesionale dhe formim gjithpërfshirës. Nisur nga problematikat e hasura në veprimtarinë e përditshme gjyqësore, angazhimi i gjyqtarit duhet të reflektohet edhe në propozimin e temave konkrete të trajnimit në SHM si dhe kryerjen e publikimeve me qëllim zhvillimin e doktrinës në të drejtën administrative.

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...} PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019- 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë

	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT			
	Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	21-30 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Mbi +99 %

		3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1.Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm
--	---	--	---------------------

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë

C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkël

)